



UDHËZUES

Për Organizimin, Funksonimin
dhe Bashkëpunimin e Komunave
me Fshatrat, Vendbanimet dhe
Lagjet Urbane

Nëntor 2024



UDHËZUES

Për Organizimin, Funksonimin
dhe Bashkëpunimin e Komunave
me Fshatrat, Vendbanimet dhe
Lagjet Urbane

Hilmi JASHARI
Gresa BERISHA

Mbështetur nga:



Përmbajtja dhe pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e National Endowment for Democracy.

TABELA E PËRMBAJTJES

7	PËRMBLEDHJE
8	1. HYRJE
9	2. RËNDËSIA E DECENTRALIZIMIT TË PUSHTETIT NË NIVEL LOKAL
9	2.1 Rëndësia e Këshillave Lokale
9	2.2 Pse Këshillat Lokale janë të rëndësishme për decentralizimin e pushtetit?
10	2.3 Standardet ndërkombëtare për Këshilla Lokale
11	3. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KËSHILLAVE LOKAL
11	3.1 Baza ligjore në Republikën e Kosovës
12	3.2 Fushëveprimi i Udhëzimit Administrativ nr. 02/2019 Për Organizimin, Funkcionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane
13	3.3 Themelimi i Komisionit të Kuvendit të Komunës për zgjedhjen e Këshillave Lokale
14	3.4 Zgjedhja e Këshillave Lokale
15	3.4.1 Zgjedhja e anëtarëve të Këshillave Lokale nga komuniteti jo shumicë
15	3.4.2 Përzgjedhja e Kryetarit të Këshillit Lokal
15	3.4.3 Procesverbalet
16	3.4.4 Kuorumi dhe çështjet administrative
16	3.5 Mandati i kryetarit dhe anëtarëve të Këshillave Lokale
18	4. BASHKËPUNIMI I KOMUNËS ME KËSHILLAT LOKALE
18	4.1 Marrëveshja e bashkëpunimit në mes të Komunës dhe Këshillave Lokale
20	4.2 Konsultimet në mes të Komunës dhe Këshillave Lokale
22	5. ZBATIMI I UDHËZIMIT ADMINISTRATIV
22	5.1 Përgjegjësia për zbatimin e Udhëzimit Administrativ
23	5.2 Monitorimi i zbatimit të Udhëzimit Administrativ
23	5.3 Financimi i aktiviteteve të Këshillave Lokale
24	5.4 Kompensimi financiar i kryetarëve të Këshillave Lokale
24	5.4.1 Udhëzime për Komunitat
25	5.4.2 Udhëzime për Këshillat Lokale
27	6. SHEMBUJ TË DOKUMENTEVE PËR KËSHILLAT LOKALE
27	Ftesa
28	Procesverbali
29	Lista e pjesëmarrësve
30	Regjistri i vendimeve
31	Deklarimi i etikës dhe konflikteve të interesit
32	Raportet

PËRMBLEDHJE

Ky udhëzues është një mjet që synon të sjellë një kuptim të drejt dhe të qartë në drejtimin dhe përgjegjësitë e këshillave lokale për fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane. Ai u ofron udhëheqësve lokal një udhëzues të detajuar dhe praktik për të zbatuar me sukses Udhëzimin Administrativ të miratuar në vitin 2019. Gjegjësisht, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr. 02/2019 Për Organizimin, Funkcionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane i cili vazhdon të jetë në fuqi.

Në një kohë kur komunitetet tona përballen me sfida të ndryshme dhe kërkesa të rritura për shërbimet dhe mbështetjen lokale, është e rëndësishme që këshillat lokale të kenë udhëzime të qarta për të siguruar që nevojat e komuniteteve të adresohen në mënyrë efektive dhe efektive.

Ky udhëzues është një burim i vlefshëm i informacionit dhe një instrument praktik për këshillat lokale dhe autoritetet lokale të qeverisjes. Duke u bazuar në kornizën ligjore ekzistuese, ky udhëzues ofron një qasje të strukturuar dhe të qartë për të kuptuar, organizuar dhe zbatuar me sukses detyrat dhe përgjegjësitë e këshillave lokale. Në këtë mënyrë, udhëzuesi mund të përdoret nga të gjitha palët si një mjet të fuqishëm për të ndërtuar dhe përparuar komunitetet tona drejt një të ardhmeje më të mirë dhe më të qëndrueshme për të gjithë banorët.





1. HYRJE

Pas hyrjes në fuqi të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 02/2019 Për Organizimin, Funkcionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane¹ në vitin 2019, janë vërejtur vështirësi në zbatimin e plotë këtij Udhëzimi dhe në hartimin e rregulloreve komunale për përcaktimin dhe kompenzimin e këshillave lokale brenda komunave përkatëse. Kjo ka ndodhur për shkak të qasjeve të ndryshme që janë përdorur nga komunat në zbatimin e Udhëzimit Administrativ nr. 02/2019 dhe mungesës së vullnetit politik për të harmonizuar këtë çështje në nivel vendi. Këto gjetje janë konfirmuar gjatë dy viteve punë në terren të Platformës Civikos, gjegjësisht takimeve me zyrtarët komunal të 12 komunave të ndryshme dhe punëtorëve me anëtarët dhe kryetarët e këshillave lokale. Në këto të fundit, është vlerësuar se mungon informacioni i mjaftueshëm për vet këshillat lokale për përgjegjësitë, detyrat dhe të drejtat e tyre, duke i bërë këto punëtori të vetmet aktivitete dedikuara ngritjes së njohurive dhe kapaciteteve për disa prej tyre, si dhe mirinformimit.

Hartimi i këtij udhëzuesi është vazhdimësi e punës paraprake me këshillat lokale në Kosovë dhe përgjigje ndaj nevojave të vërejtura për funksionimin e tyre. Tutje, me përvojën dhe ekspertizën e fituar gjatë aktiviteteve në komuna të ndryshme, udhëzuesi është hartuar që të jetë i qartë dhe i përshtatshëm për kryetarët, anëtarët dhe stafin administrativ të këshillave lokale.

Këshillat lokale luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e jetës së komunitetit dhe në adresimin e nevojave të banorëve të tyre. Për të arritur këto qëllime, është e rëndësishme që bashkëpunimi midis komunave dhe këshillave lokale të jetë i fuqishëm dhe efektiv. Këtu, udhëzuesi ofron një përjasje të strukturuar dhe të qartë për të ndihmuar këshillat lokale dhe komunat në Kosovë që të kuptojnë dhe zbatojnë me sukses dhe në plotësi Udhëzimin Administrativ nr. 02/2019 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).

Ky udhëzues nuk krijon detyrime ligjore, por në fakt ofron shpjegime të detajuara dhe gjithëpërfshirëse se si të zbatohet Udhëzimi Administrativ nr. 02/2019 i MAPL-së në nivelin e këshillave të fshatrave, të vendbanimeve dhe lagjeve urbane dhe si të sigurohet një zbatim i harmonizuar për të gjitha komunat. Si i tillë, mund të jetë shumë i dobishëm për politikëbërësit në autoritetet vendore pasi u ofron atyre për shqyrtim një sërë iniciativash, praktikash dhe zgjidhjesh të mira që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me zbatimin e Udhëzimit Administrativ nr. 02/2019. Për më tepër, mund t'iu shërbejë edhe autoriteteve qendrore dhe strukturave të ngarkuara me trajnimin e nëpunësve civilë vendorë dhe përfaqësuesve të zgjedhur.



¹ <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=21224>

2. RËNDËSIA E DECENTRALIZIMIT TË PUSHTETIT NË NIVEL LOKAL

2.1 Rëndësia e Këshillave Lokale

Funksionimi i këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane është i rëndësishme për shkak të disa arsyeve:

Përfaqësimi dhe pjesëmarrja e komunitetit: Këshillat lokale janë një forum për të përfaqësuar interesat dhe nevojat e komuniteteve të vogla në nivelin lokal. Pjesëmarrja e qytetarëve në këto këshilla lejon ata të kenë një zë dhe një rol aktiv në proceset vendimmarrëse që ndikojnë në jetën e tyre të përditshme.

Promovimi i bashkëpunimit dhe dialogut lokal: Këshillat lokale janë një platformë për të promovuar bashkëpunimin dhe dialogun mes banorëve, autoriteteve lokale dhe sektorëve të tjerë të shoqërisë civile. Përmes diskutimeve, konsultimeve dhe projekteve, këto këshilla mund të ndihmojnë në zgjidhjen e sfidave lokale dhe në ndërtimin e një shoqërie më të fortë dhe më të bashkuar.

Zhvillimi i qëndrueshëm lokal: Këshillat lokale kanë përgjegjësi për zhvillimin e qëndrueshëm të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane. Përmes planifikimit urban dhe zhvillimit të infrastrukturës së nevojshme, këto këshilla mund të ndihmojnë në sigurimin e kushteve të mira të jetesës për banorët dhe në promovimin e zhvillimit ekonomik të territorit të tyre.

Mbrojtja e ambientit dhe trashëgimisë kulturore: Këshillat lokale kanë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen dhe ruajtjen e ambientit natyror dhe trashëgimisë kulturore në zonat e tyre. Përmes hartimit dhe zbatimit të politikave të përshtatshme mjedisore dhe kulturore, ato mund të ndihmojnë në ruajtjen e identitetit të komuniteteve dhe të mjedisit të tyre natyror.

Për këto arsye, funksionimi efektiv i këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane është jetik për zhvillimin e qëndrueshëm dhe të drejtë të komuniteteve të tyre.

2.2 Pse Këshillat Lokale janë të rëndësishme për decentralizimin e pushtetit?

Decentralizimi i pushtetit dhe krijimi i këshillave lokale në komuna kanë një ndikim të madh në zhvillimin dhe funksionimin e të gjithë sistemit administrativ dhe politik. Këtu janë disa mënyra se si ndihmon decentralizimi krijimin e këshillave lokale në komuna, dhe anasjelltas, pse këshillat lokale janë të rëndësishme për decentralizimin e pushtetit:

a) Përfaqësimi i drejtpërdrejtë i komunitetit: Këshillat lokale ofrojnë një mënyrë të përfaqësimit të drejtpërdrejtë të komuniteteve në proceset vendimmarrëse. Përfaqësuesit e këshillave janë zakonisht banorë të zonave të tyre, të zgjedhur nga banorët e tjerë të komunitetit. Kjo siguron që nevojat dhe interesat e komuniteteve të reflektohen dhe të adresohen në mënyrë më të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen lokale.

b) Zhvillimi lokal i politikave dhe strategjive: Këshillat lokale kanë kompetencë për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive lokale. Duke pasur qasje më të drejtpërdrejtë në nevojat dhe sfidat e komuniteteve të tyre, këshillat lokale mund të zhvillojnë politika dhe strategji që janë më të përshtatshme dhe efektive për të përmbushur qëllimet e zhvillimit lokal.

c) Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies: Prania e këshillave lokale rrit transparencën dhe llogaridhënien në proceset vendimmarrëse. Vendimet dhe veprimet e këshillave lokale janë të hapura

për qytetarët dhe mund të monitorohen dhe vlerësohen më lehtë nga publiku. Kjo rrit llogaridhënien dhe përgjegjësinë e autoriteteve lokale ndaj qytetarëve.

d) Stimulimi i pjesëmarrjes së qytetarëve: Krijimi i këshillave lokale inkurajon pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në jetën politike dhe shoqërore të komuniteteve të tyre. Qytetarët kanë mundësinë të kontribuojnë në diskutime, të japin propozime dhe të ndjekin zhvillimet në komunitetin e tyre përmes këtyre këshillave.

e) Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve lokale: Këshillat lokale kanë mundësinë të koordinojnë dhe të mbikqyrin shërbimet lokale, duke përmirësuar qasjen dhe cilësinë e tyre. Përfaqësuesit e këshillave mund të ndihmojnë në identifikimin e nevojave dhe prioriteteve të komunitetit dhe të përcaktojnë mënyra për të përmirësuar shërbimet lokale për të përmbushur këto nevoja. Përmbushja e këtyre funksioneve dhe përparimeve është thelbësore për një proces efektiv të decentralizimit dhe për ndërtimin e një qeverisje lokale të qëndrueshme dhe të përgjegjshme.

2.3 Standardet ndërkombëtare për Këshilla Lokale

Ndërkombëtarisht, ekzistojnë disa standarde dhe rekomandime për funksionimin dhe rolin e këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane. Këto standarde janë zhvilluar nga organizata ndërkombëtare dhe institucione të ndryshme që promovojnë demokracinë, zhvillimin lokal dhe qeverisjen e mirë. Disa nga standardet më të rëndësishme dhe të njohura janë:

Karta e Pushtetit Lokal (European Charter of Local Self-Government)

Kjo kartë, e hartuar nga Këshilli i Evropës, është një instrument juridik ndërkombëtar që përcakton standardet për autonomi të plotë dhe efektive të autoriteteve lokale. Ajo përcakton të drejtat dhe detyrimet e autoriteteve lokale dhe rregullon qasjen e tyre në zbatimin e politikave lokale dhe në vendimmarrjen.

Rekomandimet e OKB-së për Qeverisjen Lokale dhe Autonomitë Lokale (United Nations Recommendations on Local Government and Autonomy)

Këto rekomandime përcaktojnë standardet për zhvillimin e qeverisjes lokale dhe autonomisë së autoriteteve lokale. Ata përshkruajnë mënyrat se si duhet të funksionojnë autoritetet lokale dhe çfarë kompetencash duhet tu jepen atyre.

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm apo Agjenda 2030 (Sustainable Development Goals - SDGs/ Agenda 2030)

Objektiva 16 e Zhvillimit të Qëndrueshëm (të Agjendës 2030) përfshin targete të veçanta për promovimin e paqes, drejtësisë dhe institucioneve të forta dhe efektive, duke përfshirë qeverisjen lokale si një element kyç.

Konventat e Këshillit të Evropës mbi Qeverisjen Demokratike Lokale

Këto konventa përcaktojnë standardet minimale që duhet të përmbushen nga autoritetet lokale për të siguruar një qeverisje demokratike dhe transparente. Ato përfshijnë zbatimin e proceseve demokratike, transparencën, llogaridhënien dhe respektimin e të drejtave të njeriut në nivel lokal.

Bashkimi Ndërkombëtar i Autoriteteve të Vendit (International Union of Local Authorities - IULA/ UCLG)

Kjo organizatë promovon bashkëpunimin ndërkombëtar mes autoriteteve lokale dhe ndërtimin e kapaciteteve për të përmbushur detyrat e tyre në mënyrë efektive dhe të drejtë.

Këto standarde dhe rekomandime janë konsideruar si pika referimi dhe udhëzues për të cilat autoritetet lokale mund të ndërtojnë dhe vlerësojnë sistemet e tyre lokale të qeverisjes dhe të sigurojnë një funksionim të efektshëm dhe të përshtatshëm të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

3. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KËSHILLAVE LOKAL

3.1 Baza ligjore në Republikën e Kosovës

Duhet theksuar se burimet e së drejtës të qeverisjes lokale në Republikën e Kosovës janë të karakterit formal/juridik. Disa nga burimet e së drejtës të qeverisjes lokale në Republikën e Kosovës janë:

- a) Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- b) Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;
- c) Vendimet e Gjykatës Kushtetuese;
- d) Ligjet;
- e) Statutet e Komunave;
- f) Rregulloret dhe Udhëzimet Administrative të nxjerra nga Ministria përgjegjëse për qeverisje lokale;
- g) Rregulloret e Komunave.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës² përbën bazën kryesore juridike për vetëqeverisje lokale, dhe atë në dy kapituj. Në Kapitullin I në Dispozitat Themelore, Neni 12 (me dy paragrafë), dhe në Kapitulli X në dy Nene, 123 (me katër paragrafë) dhe 124 (me shtatë paragrafë), i trajton parimet themelore të vetëqeverisjes lokale, përkatësisht organizimin dhe funksionimin e vetëqeverisjes lokale. Një nga garancitë themelore të Kushtetutës është se e siguron vetëqeverisjen lokale dhe garanton rregullimin me ligj të së njëjtës. Ndërsa në Nenin 123 paragrafi 1 thekson: *“Njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës është komuna. Komunitetet gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.”*

Përderisa vetëqeverisja lokale e komunave burimin juridik e ka në nenet e lartpërmendura të Kushtetutës, këshillat lokale burimin juridik e kanë në ligjin themelor, **Ligjin (nr. 03/I-040) Për Vetëqeverisje Lokale të vitit 2008**³. Ky Ligji i ndër të tjera në Nenin 34, me katër paragrafë ka përcaktuar bazën themelore juridike për funksionimin e këshillave lokale:

- Çështja e parë e përcakton detyrimin ligjor të ministrisë përkatëse për vetëqeverisje lokale për nxjerrjen e udhëzimeve administrative për marrëveshjet ndërmjet komunës dhe fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.
- Çështja e dytë e trajton të drejtën e fshatrave vendbanimeve dhe lagjeve urbane që me aprovimin e komunës të kryejnë aktivitete që janë përgjegjësi e komunës.
- Çështja e tretë parasheh që çdo komunë mund të bëjë marrëveshje me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane brenda territorit të vet për të siguruar përmbushjen e të gjitha nevojave të të gjithë qytetarëve të komunës, dhe
- Çështja e katërt parasheh që statutet dhe rregulloret e komunës duhet të parashikojnë formën e bashkëpunimit.

Fuqia e kësaj baze juridike në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale ka nxit detyrimin që kjo formë e bashkëpunimit në mes të komunave dhe fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të

² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

konkretizohet më tej në **Udhëzimin Administrativ** që e nxjerr ministria përgjegjëse për vetëqeverisje lokale. Udhëzimi i parë është nxjerrë në korrik të vitit 2008, dhe ka synuar të rregullojë kryesisht formën e marrëveshjes dhe fushëveprimin e këtyre marrëveshjeve në mes të komunës fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane. Ky Udhëzim Administrativ 2008/08 ka qenë për nga përmbajtja shumë i kufizuar, dhe në gjithsej 10 nene ka synuar të ketë objekt rregullimin ligjor kryesisht të formës së marrëveshjes, mënyrën e financimit dhe gjithashtu përgjegjësinë për zbatim dhe monitorim. Ndërsa çështjet e tjera sa i përket organizimit, zgjedhjes, rregullimit të fshatrave vendbanimeve dhe lagjeve urbane nuk ka qenë i rregulluar dhe kjo është lënë në kompetencë të komunave që përmes statuteve dhe rregulloreve të komunës të bëjnë këtë organizim. Kjo ka pas edhe mangësitë e veta sepse lënia në diskrecion të komunave që secila të bëjë organizimin në bazë diskreionale dhe vetanake nuk ka siguruar qasje uniforme në nivel vendi.

Ky Udhëzim Administrativ është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Udhëzimit tjetër i nxjerr në 2019, **Udhëzim Administrativ (MAPL) nr. 02/2019 Për Organizimin, Funkzionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane**.

Aktet nënligjore të kuvendit komunal, por edhe ato të organeve qendrore të cilat i nxjerr ministria përkatëse për qeverisje lokale, janë burime të së drejtës së qeverisjes lokale. Kuvendi komunal, por edhe Kryetari i Komunës përkatëse, brenda fushëveprimit të kompetencave të tyre kanë të drejtë të miratojnë akte të caktuara nënligjore. Me qëllim të qeverisjes së mirë të komunave, në pamjaftushmëri të normave ligjore edhe organet qendrore miratojnë akte nënligjore (udhëzime administrative dhe rregullore) të cilat vlejné për të gjitha komunat. Si akte nënligjore të cilat janë nxjerrë nga organet qendrore dhe që janë aktualisht në fuqi në Republikën e Kosovës mund të përmendim: Udhëzimin Administrativ për Organizimin, Funkzionimin dhe Bashkëpunimin në mes të Komunave me Fshatrat, Lagjet dhe Vendbanimet Urbane; Udhëzimi Administrativ për Zbatimin e Përgjegjësisë së Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal në Lidhje me Monitorimin dhe Mbikëqyrjen e Komunave; Rregullorja për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave; Rregullorja për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës; Udhëzimi Administrativ për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna etj.

3.2 Fushëveprimi i Udhëzimit Administrativ nr. 02/2019 Për Organizimin, Funkzionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane

Qëllimi i Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 02/2019 Për Organizimin, Funkzionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane⁴, kishte për synim kryesor që të plotësonte boshllëkun nga Udhëzimi paraprak i 2008. Udhëzimi i vitit 2008 kishte rregulluar çështjet e marrëveshjes së bashkëpunimit të komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, derisa pjesa organizimit dhe funksionimit kishin mbetur të pazgjidhura dhe në kompetencë të komunave që të bëjnë këtë rregullim mbi baza të diskrecionit vetanak. Për shkak të dallimeve në fushën e rregullimit dhe të qasjeve të ndryshme të komunave në organizimin e këshillave lokale, ky Udhëzim Administrativ i vitit 2019 do të zgjidhte këtë sfidë duke ofruar një bazë gjithëpërfshirëse juridike për të gjitha komunat në Kosovë. Prandaj, edhe përcaktimi i Udhëzimit fokusohet në organizimin dhe funksionimin e këshillave lokale.

Një nga nenet e këtij Udhëzimi, përcakton qartazi qëllimin e delegimit të kompetencave të komunave për këshillat lokale duke e theksuar “në ushtrimin e disa aktiviteteve të cilat janë në përgjegjësi dhe kompetencë të komunës”. Ndaj, është synim themelor i këtij Udhëzim që të bartën disa “kompetenca” të komunave në nivel të këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Nenet e këtij Udhëzimi për përkufizimet përfshijnë vetëm dy terme: “Këshillat Lokale” dhe “Kryetari i Këshillit”. Këshillat lokale përkufizohen si organe (trupa) të zgjedhura të cilat përfaqësojnë në mënyrë të organizuar komunitetin e fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve urbane. Derisa për kryetarin theksohet se nënkupton personin më të votuar në tubimin zgjedhor. Tubimi zgjedhor dhe përfshirja

4 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=21224>

përcaktohen me nenet e tjera vijuese për procedurën e votimit dhe shtrirjen gjeografike të zonës së vendbanimit, fshatrave apo lagjeve urbane.

Natyrshëm, nenet e këtij Udhëzimi përcaktojnë edhe kriteret themelimit e këshillave për komunat përkatëse duke përdor numrin e banorëve si bazë themelore. Konkretisht:

- Për deri në 10,000 banorë, komuna duhet të ketë deri në 4 këshilla lokale.
- Për deri në 10,000 banorë, komuna duhet të ketë deri në 4 këshilla lokale.
- Për numrin e banorëve nga 10,001 deri në 20,000, komuna duhet të ketë deri në 8 këshilla lokale.
- Për numrin nga 20,001 deri në 30,000 banorë, numri i këshillave arrin deri në 12.
- Për numrin me 30,001 deri në 50,000 banorë, duhet të ketë deri në 20 këshilla lokale.
- Për 50,001 deri në 70,000 banorë, komuna themelon deri në 25 këshilla lokale.
- Për 70,001 deri në 100,000 banorë, numri shkon deri në 30 këshilla lokale.
- Komunat me mbi 100,001 banorë mund të kenë deri në 40 këshilla lokale.
- Ndërsa Kryeqyteti i Kosovës duhet të ketë deri në 50 këshilla lokale.

Ky sistem siguron që përfaqësimi lokal të jetë në përpjesëtim të drejtë me popullsinë e komunave.

3.3 Themelimi i Komisionit të Kuvendit të Komunës për zgjedhjen e Këshillave Lokale

Kuvendet komunale janë përgjegjëse për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale, dhe zgjedhja e këtij komisioni duhet të përputhet me mandatin e kuvendeve komunale. Kjo duhet të ndodhë menjëherë pas zgjedhjeve kur krijohen kuvendeve komunale, për arsyen themelore që mandati i komisionit është i lidhur me mandatin e kuvendit komunal. Qëllimi është të sigurohet qëndrueshmëria në zgjedhjen e këshillave lokale, si edhe të trajtohen rastet e dorëheqjeve ose heqjes së mandateve të kryetarëve për rrethana të përcaktuara nga Udhëzimi i lartëcekur. **Kuvendet duhet të jenë në gjendje të plotësojnë dhe të sigurojnë funksionimin e këshillave lokale (Neni 5, Par. 1).**

Komisioni komunal duhet të ketë përbërje prej shtatë anëtarëve: katër prej tyre anëtarë të kuvendit të nga subjektet e ndryshme politike të përfaqësuara në kuvend, një anëtar zgjidhet nga ekzekutivi i komunës (që mund të jetë punonjës i ekzekutivit të komunës), një anëtar nga komuniteti ku zgjidhet këshilli lokal, dhe një përfaqësues nga OJQ-të që kanë rol dhe angazhim në nivelin lokal. Në rast se nuk ka OJQ lokale, nuk përjashtohen të përfshihen përfaqësues të OJQ-ve rajonale apo të organizatave të tjera në nivel nacional (Neni 5, Par. 2).

Komisioni duhet të ketë përbërje etnike edhe gjinore sipas kërkesave ligjore. Ligji për Barazi Gjinore⁵ obligon shprehimisht që përbërja duhet të jetë e nivelit të barabartë. Ndërsa, përbërja etnike duhet të rregullohet sipas përfaqësimit të komuniteteve pakicë në komunën përkatëse, e që minimalisht do të duhej të përfshinte një anëtar nga komunitet i cili gjithashtu mund t'i përkoj gjinisë e cila është më pak e përfaqësuar në komision (Neni 5, Par. 3).

Në kuptim të transparencës dhe llogaridhënës si parime themelore për funksionim demokratik të autoriteteve, është parashikuar që komisioni komunal t'i raportoj kuvendit komunal - autoritetit i cili e ka zgjedhur komisionin. Raportimet e tilla nuk janë kufizuar se sa herë mund dhe duhet të raportojë, por sipas frymës edhe të neneve tjera, nënkupton që komisioni për çdo zgjedhje përkatëse duhet të mbajë shënim zyrtar për procesin zgjedhor dhe t'i raportojë gjithashtu kuvendit në mënyrë verbale dhe duke prezantuar raportin me shkrim.

⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923>

Përgjegjësia e komisionit komunal për zgjedhje të këshillave lokale nis me themelimin e tij nga kuvendi, dhe i përgjigjet dhe i raporton të njëjtit kuvend derisa të shuhet qoftë në bazë të zgjedhjeve të rregullta komunale apo të atyre të jashtëzakonshme. Me themelimin e kuvendit të ri, ky kuvend themelon komisionin tjetër, por që nuk përjashton mundësinë e përfshirjes së anëtarëve që kanë qenë edhe në komisionin e mëparshëm. Sidoqoftë, **përgjegjësia e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale nis dhe mbaron njëjtë me mandatin e kuvendit komunal përkatës** (Neni 6, Par. 5).

3.4 Zgjedhja e Këshillave Lokale

Rregulloret e komunave të miratuara për zbatimin e Udhëzimit Administrativ janë përpiluar me kujdes për të siguruar një proces zgjedhor tërësisht transparent dhe efikas. Në këto rregullore, një prej pikave kyçe është përcaktimi i punës së komisionit komunal për zgjedhje të këshillave lokale. Komunitetet kanë përcaktuar që përmes zyreve për informim të njoftohen fshatrat, lagjet dhe vendbanimet në afatin 15-ditor para datës së zgjedhjes së këshillave lokale. Këto njoftime publikohen në vende të dukshme publike, në media lokale dhe përmes faqeve zyrtare në internet. Po ashtu, ato duhet të përfshijnë informacione të rëndësishme si rendin e ditës dhe detaje mbi kohën dhe vendin e mbajtjes së zgjedhjeve.

Zgjedhja e këshillave lokale nëpërmjet rregulloreve komunale është vendosur që të realizohet qoftë përmes votimit të hapur apo votimit të fshehtë, varësisht përcaktimit të shumicës së pjesëmarrësve. Kjo do të thotë që çdo votues ka të drejtën dhe mundësinë për të shprehur preferencat e tyre të zgjedhjes pa u ndikuar nga presioni apo ndikimi i faktorëve të tjerë. Të drejtën e votës do të kenë individët mbi moshën 18 vjeçare, të cilët kanë vendbanimin në ato fshatra, vendbanime apo lagje urbane ku zhvillohen zgjedhjet. Kjo siguron një përfshirje të gjerë të komunitetit në procesin zgjedhor dhe një përfaqësim më të drejtë të interesave të tyre në këshillin lokal.

Një nga kriteret e përqaftuara nga të gjitha komunitetet është ndalimi i zgjedhjes së kandidatëve që mbajnë pozita politike apo përfaqësojnë partitë politike në këshillin lokal. Kjo politikë synon të sigurojë një pavarësi dhe neutralitet të plotë të këshillit lokal, duke shmangur ndikimin e partive politike dhe përkatësisht të qeverisjes qendrore në proceset vendimmarrëse lokale. Kjo përqaftje ka për qëllim të përforcojë autonominë dhe pavarësinë e këshillit lokal, duke e bërë atë të fokusohet drejtpërdrejt në nevojat dhe interesat e komunitetit lokal, pa u përzier në lojën e politikës së partive qendrore. Kështu, kandidatët zgjedhur do të kenë mundësinë për të përfaqësuar dhe shërbyer në mënyrë të pavarur dhe të qëllimshme për mirëqenien e banorëve të tyre.

Përbërja e këshillave lokale është e përcaktuar sipas Udhëzimit nr. 02/2019 me kufijtë minimal dhe maksimal të përbërjes së këshillave lokale. **Përbërja minimale është pesë anëtarë, ndërsa ajo maksimale është nëntë anëtarë.** Në këtë kuadër, komunave u është lënë diskrecion që me akte rregullatore komunale, përkatësisht rregulloreve komunale, të përcaktojnë numrin përkatës të përbërjes në vartësi të numrit të popullatës dhe shtrirjes gjeografike (Neni 6, par. 1).

Në një pjesë të rasteve, komunitetet kanë lënë në diskrecion të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane përcaktimin e numrit të anëtarëve të këshillave lokale. Kjo përputhet me kufijtë minimal dhe maksimal të numrit të anëtarëve të këshillave (pesë deri në nëntë), që janë caktuar në rregullore. Ky kufizim i numrit të anëtarëve synon të sigurojë një strukturë të përshtatshme për përfaqësimin komunal, duke iu dhënë mundësi vendbanimeve, fshatrave dhe lagjeve urbane mundësinë për të ndikuar në vendimmarrjen lokale dhe për të adresuar çështjet që kanë rëndësi për komunitetin e tyre.

Paragrafi në vijim i Nenit 6 i Udhëzimit nr. 02/2019 më pas përcakton detyrimin që të ketë përfshirje të çdo fshati vendbanimi apo lagjeje:

Këshilli duhet të përfshijë përfaqësimin e çdo fshati, vendbanimi apo lagje urbane, përfshirë përfaqësim gjinor dhe etnik.

Zgjidhja e kësaj çështje nga komunat është bërë duke përcaktuar në rregullore komunale në mënyrë se secili fshat, vendbanim apo lagje urbane duhet të jetë i përfaqësuar me një anëtar në këshill, ndërsa në rastet kur numri i fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane është qift atëherë vendbanimi që ka më shumë banorë do të ketë dy anëtarë. Edhe në këtë përbërje kërkohet të ketë përfshirje të barabartë gjinore, që është standardi i njëjtë edhe për komisionin komunal për zgjedhje të këshillave lokale. Sigurisht se përveç qëllimeve të tjera ligjore për përfaqësim të barabartë gjinor dhe etnik, synimi sipas këtij Udhëzimi është që të ketë përfaqësim të denjë dhe barabartë në artikullimin e interesave të komuniteteve përkatëse.

3.4.1 Zgjedhja e anëtarëve të Këshillave Lokale nga komuniteti jo shumicë

Një kriter bazë për përcaktimin e përbërjes së këshillave lokale nga komuniteti jo shumicë është proporcioni i përfaqësimit të tyre në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane. Ky proporcion përcaktohet në bazë të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, duke u bazuar në të dhënat e aktualizuara të strukturës së komunitetit në atë kohë. Kjo metodë siguron një përfaqësim të drejtë të komunitetit në këshillin lokal, duke reflektuar saktësisht strukturën dhe peshën e secilit vendbanim në vendimmarrjen komunale. Duke u mbështetur në të dhënat zyrtare të regjistrimit të popullsisë, ky kriter ofron një bazë të qëndrueshme dhe transparente për përcaktimin e përfaqësimit të komunitetit jo shumicë në procesin zgjedhor.

3.4.2 Përzgjedhja e Kryetarit të Këshillit Lokal

Kryetari i këshillit zgjidhet në bazë të numrit më të madh të votave që merr kandidati në tubimin zgjedhor. Në rast se në rrethin e parë të votimit ka kandidatë që kanë numër të barabartë të votave, atëherë organizohet rrethi i dytë i votimit. Në këtë fazë, kandidatët e barabartë shkojnë në një proces shtesë zgjedhjesh për të vendosur kryetarin e këshillit lokal. Pas këtij votimi të dytë, kandidati që merr numrin më të madh të votave në këtë rreth të dytë, shpallet kryetar i këshillit lokal. Kjo procedurë siguron një zgjedhje të qartë dhe të drejtë për kryetarin e këshillit, duke u bazuar në mbështetjen dhe preferencat e komunitetit lokal.

3.4.3 Procesverbalet

Lidhur me ecurinë e tubimit zgjedhor për zgjedhjen e këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, hartohet një procesverbal i cili është paraparë në shumicën e rregulloreve komunale si dokument zyrtar i përfshirë në këto akte. **Procesverbali i tubimit zgjedhor duhet të përmbajë informacione të rëndësishme si koha, ora, vendi, numri i pjesëmarrësve në listë të nënshkruar, të dhënat për anëtarët e këshillave lokale dhe kryetarin, si dhe shënime mbi ecurin e procesit zgjedhor.**

Për më tepër, procesverbalit duhet t'i jepet një karakter zyrtar duke e nënshkruar nga anëtarët e komisionit komunal, procesmbajtësi, kryetari i tubimit, dhe anëtarët e këshillit lokal. Komisioni ka një detyrim ligjor që t'i raportojë kuvendit për punën në tubimin zgjedhor, duke përfshirë të gjitha detajet e procesit zgjedhor dhe rezultatit të zgjedhjeve. Poashtu, ata janë të detyruar të bëjnë publike emrat e të zgjedhurve për këshillat lokale, duke siguruar transparencë të plotë në procesin zgjedhor për komunitetin.

3.4.4 Kuorumi dhe çështjet administrative

Në shumicën e rregulloreve komunale, është përcaktuar se **kuorumi për të përfunduar zgjedhjen duhet të jetë së paku dyfishi i numrit të anëtarëve që duhet të zgjidhen**. Ky kriter siguron që vendimet e marra nga këshilli lokal të kenë një bazë mjaftueshme për të përfaqësuar vullnetin e komunitetit. Kjo mënyrë e caktimit të kufijve të pjesëmarrjes siguron që vendimet e marra nga këshillat lokale pas zgjedhjeve të përfaqësojnë vullnetin real të komunitetit dhe të kenë legjitimitet të plotë në sytë e banorëve.

Ajo që është e patrajtuar nga udhëzimet administrative, dhe në disa raste edhe nga rregulloreve të komunave, është mungesa e një procedure të qartë për trajtimin e ankesave në lidhje me procesin zgjedhor të këshillave lokale. Vetëm disa komuna kanë parashikuar një komision për ankesa, i cili përbëhet nga tre anëtarë të autorizuar për të pranuar ankesat dhe për të vendosur për to brenda një periudhe 15-ditore.

Në rastet kur nuk është parashikuar një komision i veçantë për ankesa, është supozuar që komisioni i përhershëm i ankesave në komunë do të duhej të trajtonte ankesat e mundshme lidhur me procesin zgjedhor. Kjo mund të ketë krijuar një vakum ligjor dhe administrativ që ka lënë hapësirë për moszbatimin e një procedure të rregullt dhe të drejtë për trajtimin e ankesave zgjedhore. Ndërsa disa komuna kanë vepruar për të adresuar këtë mungesë, është e nevojshme që të gjitha të bëjnë të njëjtën gjë për të siguruar që çdo ankesë zgjedhore të trajtohet në mënyrë të drejtë dhe transparente, duke u siguruar që procesi zgjedhor të jetë i besueshëm dhe i ligjshëm për të gjithë qytetarët.

Gjithashtu, një çështje me rëndësi administrative që nuk është trajtuar as në Udhëzimin Administrativ, as në rregulloret e komunave, është mungesa e një akti administrativ për të konfirmuar zgjedhjen dhe mandatin e kryetarit apo anëtarëve të këshillave lokale. Përveç procesverbalit dhe detyrimit për të bërë publike emrat e të zgjedhurve në këshillat lokale, nuk është specifikuar asnjë akt që do të shërbejë si dokument zyrtar individual për personat e zgjedhur.

Në rastin e mandatit të kuvendeve komunale, për të cilin komisioni komunal për zgjedhje të këshillave raporton, është e vështirë të kuptohet pse nuk është parashikuar një akt me të cilin të legjitimohet zgjedhja e anëtarëve dhe kryetarëve të këshillave. Në rast se kuvendi për arsye të ndryshme nuk mund të miratojë një vendim të tillë, kjo kompetencë mund të kalojë te kryetari i komunës, i cili ka përgjegjësi sipas Udhëzimit Administrativ për zbatimin e të njëjtit. Kjo situatë mund të krijojë vështirësi dhe pasiguri ligjore, pasi nuk ka një dokument zyrtar që të certifikojë zgjedhjen e personave në pozitat e këshillave lokale. Është e rëndësishme që të adresohet ky boshllëk ligjor dhe administrativ për të siguruar një proces të plotë dhe transparent për konfirmimin e zgjedhjeve dhe mandateve të kryetarëve dhe anëtarëve të këshillave lokale.

3.5 Mandati i kryetarit dhe anëtarëve të Këshillave Lokale

Në relacion me mandatet, **parimi bazë për mandatin e këshillave lokale është mandati i kuvendeve komunale që është 4 vjeçar**. I njëjti mandat u trajtua edhe në rastin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale e që themelohet nga kuvendit. Pra, këto mandate të këshillave lokale dhe komisionit për zgjedhjen e tyre fillojnë dhe ndërprehen në mënyrë të njëjtë me atë të kuvendeve komunale.

Përveç kësaj rrethane juridike që lidhet me zgjedhjet në nivel lokal e pastaj me themelimin e kuvendeve komunale si rezultat i zgjedhjeve, Udhëzimi Administrativ ka parashikuar të gjitha rrethanat e tjera të cilat mund të shkaktojnë ndërprerjen e mandatit të kryetarit apo anëtarëve të këshillit, si në vijim:

- a) Në rast të dorëheqjes;
- b) Shkarkimit;
- c) Ndërrimit të vendbanimit;
- d) Dënimi për vepër penale me burgim mbi gjashtë muaj;

e) Në raste vdekje.

Në rastet e shkarkimit të kryetarit të këshillit dhe anëtarëve të saj, zbatohet procedura e njëjtë si në rastin e zgjedhjes së tyre.

Rregulloret komunale si parim të përgjithshëm kanë parashikuar, mundësinë e ndërprerjes së mandatit të anëtarit apo kryetarit të këshillit në rast se banorët konsiderojnë se ata nuk janë duke përmbushur obligimet sipas Udhëzimit, me iniciativën e më shumë se gjysmës së pjesëmarrësve në momentin e zgjedhjes së kryetarit apo anëtarit të këshillit. Kjo iniciativë duhet të dëshmohet me nënshkrimet e ofruara nga banorët dhe duhet t'i drejtohet komisionit komunal, i cili brenda afatit prej 30 ditësh duhet të organizojë tubimin zgjedhor për të adresuar çështjen.

Përderisa në rastin e ndërprerjes së mandatit të kryetarit të këshillit lokal afati për organizimin e zgjedhjeve të reja është 30 ditor, për zëvendësimin e anëtarit të këshillit afati kohor është 15 ditë.

Gjithashtu, procedura e zgjedhjes pas shkarkimit apo ndërprerjes së mandatit është më e thjeshtë dhe kryhet me automatizim, që nënkupton se zgjidhja bëhet nga lista e pritjes të cilën komisioni komunal duhet ta ketë në rastin e zgjedhjes së këshillave lokale. Kjo procedurë siguron një mekanizëm demokratik për të adresuar çështjet e shqetësimit të banorëve në lidhje me përmbushjen e detyrimeve nga ana e anëtarëve dhe kryetarit të këshillit lokal. Duke i dhënë banorëve këtë mundësi të shkarkimit, rregulloret komunale synojnë të sigurojnë llogaridhënie dhe përgjegjësi ndaj komunitetit, duke promovuar transparencën dhe llogaridhënien në qeverisjen lokale.



4. BASHKËPUNIMI I KOMUNËS ME KËSHILLAT LOKALE

Bashkëpunimi përbën çështje themelore të të gjithë Udhëzimit Administrativ sepse përfshin kompetencat të cilat i delegohen këshillave lokale.

Neni 8 i Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 02/2019 Për Organizimin, Funkcionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane shënon një **pjesë kyçe të përgjegjësisë dhe të drejtave të këshillave lokale për bashkëpunim me autoritetet komunale si një instrument thelbësor në drejtim të koordinimit të veprimeve dhe përkrahjes së komunës për nevojat e komunitetit lokal.**

Në lidhje me kompetencat e komunës, veçanërisht në aspektet e planifikimit urban dhe rural, furnizimit me ujë, rregullimit të kanalizimit, drenazhimit, shëndetësisë publike, mbrojtjes së ambientit, turizmit, hapësirave publike dhe varrezave, si dhe aktiviteteve kulturore dhe sportive, është e rëndësishme që të kuptohet se përbushja e këtyre detyrave kërkon përpjekje të përbashkëta dhe koordinim të vazhdueshëm.

Shembull, në planifikimin urban dhe rural, komuna dhe këshillat lokale duhet të bashkëpunojnë në hartimin e planeve afatgjata dhe të afërta duke marrë parasysh nevojat dhe aspiratat e banorëve. Në aspektin e shëndetësisë publike, bashkëpunimi duhet të fokusohet në sigurimin e shërbimeve të cilat promovojnë shëndetin dhe parandalimin e sëmundjeve në nivel lokal.

Në fushën e mbrojtjes së ambientit, bashkëpunimi duhet të adresojë sfidat mjedisore në nivel lokal, duke përqendruar përpjekjet në rregullimin e mbeturinave, ndërtimin e infrastrukturës së qëndrueshme dhe promovimin e praktikave mjedisore.

Turizmi, si një burim i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik lokal, kërkon koordinim të veprimeve për të promovuar atraksionet turistike dhe për të siguruar infrastrukturën e nevojshme për pritjen e vizitorëve.

Hapësirat publike dhe aktivitetet kulturore dhe sportive janë elemente kyçe të jetës komunitare, dhe bashkëpunimi midis komunës dhe këshillave lokale në këto fusha ndihmon në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve sociale dhe sportive.

Në përputhje me këto kompetenca, Udhëzimi Administrativ synon të inkurajojë dhe të ndihmojë në formimin e partneriteteve efektive lokale, në mënyrë që të arriten qëllimet e përbashkëta për përparimin dhe zhvillimin e komunitetit.

4.1 Marrëveshja e bashkëpunimit në mes të Komunës dhe Këshillave Lokale

Udhëzimi Administrativ për Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane është një instrument që ndihmon në rregullimin dhe koordinimin e marrëdhënieve mes komunës dhe qendrave të vogla administrative. **Kjo marrëveshje, sipas Udhëzimit, duhet të përmbajë disa elemente themelore për të siguruar që bashkëpunimi të jetë efektiv dhe transparent.**

Në lidhje me elementet e marrëveshjes, është e rëndësishme që të përcaktohet:

- a) **Objekti i marrëveshjes**, duke specifikuar qartë qëllimin dhe fushën e veprimtarisë së bashkëpunimit;

- b) **Kohëzgjatja e marrëveshjes**, e përcaktuar me qartësi për të shmangur ndonjë ndërprerje apo moskuptim në zbatimin e saj;
- c) **Përshkrimi i obligimeve për palët**, që përfshin detyrimet e secilës palë, duke specifikuar përgjegjësitë dhe kontributet e tyre në zbatimin e marrëveshjes;
- d) **Dinamika e realizimit të punëve**, e përcaktuar në mënyrë që të sigurohet përparimi i qëllimeve të përcaktuara në kohë dhe në mënyrë efektive;
- e) **Kostoja financiare**, e cila është element esencial për të siguruar që resurset financiare janë të disponueshme për të mbështetur implementimin e marrëveshjes.

Neni 2 i Udhëzimit specifikon se objekti i marrëveshjes nuk mund të përfshijë përgjegjësitë e kuvendit të komunës që përcaktohen në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale (Neni 40, Par. 2). Gjegjësisht, nuk mund të përfshijë:

- a) Statutin dhe Rregulloren e Punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
- b) Miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- c) Miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas Statutit apo Rregullores së Punës;
- d) Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- e) Themelimin e komisioneve të kërkuara sipas këtij Ligji;
- f) Zgjedhjen e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të komunës;
- g) Niveli i tarifave dhe ngarkesave;
- h) Krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- i) Emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike; j) arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale;
- j) Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe
- k) Përgjegjësitë të tjera që kërkohen me ligj.

Këto kufizime janë vendosur për të mbajtur qartësinë dhe për të parandaluar përplasje të kompetencave mes institucioneve lokale. Përfundimisht, këto dispozita për bashkëpunim nënvizojnë rëndësinë e përmirësimit të bashkëpunimit dhe koordinimit mes komunës dhe qendrave të vogla administrative për të përshpejtuar zhvillimin dhe për të adresuar nevojat e përbashkëta të komuniteteve lokale.

Marrëveshjet e bashkëpunimit duhet të procedohen tutje me një kërkesë për miratim nga Drejtoria përkatëse, me qëllim që të sigurohet se marrëveshjet e tilla janë në përputhje me ligjin dhe politikën e përcaktuara nga institucioni zyrtar përgjegjës në nivel komunal. Dhe gjithashtu, të sigurohet se Drejtoria njëkohësisht mbartë të gjithë përgjegjësinë për vlefshmërinë dhe ligjshmërinë e marrëveshjes së arritur.

Miratimi zyrtar nga Drejtoria përkatëse përmbush disa funksione kyçe:

- a) **Ligjshmërinë:** Siguron që marrëveshjet janë të përputhshme me ligjin dhe rregulloret e zbatueshme në nivel lokal dhe nacional.
- b) **Transparencën:** Duke kaluar nëpër procesin e miratimit zyrtar, marrëveshjet bëhen transparente për të gjithë palët e interesuara dhe për publikun në përgjithësi.

- c) **Përgjegjësinë financiare:** Miratimi nga Drejtoria përkatëse siguron që komuna është e gatshme financiarisht për të mbështetur zbatimin e marrëveshjeve dhe për të siguruar që aspektet financiare janë të qarta dhe të kontrollueshme.
- d) **Përputhshmërinë me politikat lokale:** Siguron që marrëveshjet janë në përputhje me politikat dhe strategjitë lokale të komunës, duke ndihmuar në përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit.

Miratimi nga Drejtoria përkatëse gjithashtu reflekton një proces administrativ të përcaktuar, duke përfshirë vlerësimin e përmbajtjes së marrëveshjes, vlerësimin e ndikimit të saj, dhe sigurimin e pajtueshmërisë së saj me ligjin dhe politikat e përcaktuara.

Në përgjithësi, kjo kërkesë për miratim zyrtar nga Drejtoria përkatëse është një masë e rëndësishme për të siguruar që marrëveshjet midis komunës dhe këshillave lokale janë të qëndrueshme, legjitime dhe të përputhshme me qëllimet dhe politikat e përcaktuara nga autoritetet komunale.

4.2 Konsultimet në mes të Komunës dhe Këshillave Lokale

Nenet e Udhëzimit Administrativ theksojnë rëndësinë e komunikimit dhe bashkëpunimit të drejtpërdrejtë midis kryetarit të komunës, kryesuesit të kuvendit dhe kryetarëve të këshillave lokale për të siguruar pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e këshillave në proceset vendimmarrëse dhe konsultative.

Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit organizojnë së paku dy takime në vit me Kryetarët e Këshillave Lokale⁶


Kjo dispozitë për dy takime vjetore thekson rëndësinë e komunikimit të rregullt dhe të strukturuar mes kryetarit të komunës, kryesuesit të kuvendit dhe kryetarëve të këshillave lokale. Takimet periodike ofrojnë mundësinë për të adresuar çështje të rëndësishme për komunitetin në një mjedis të hapur dhe bashkëpunues. Përmes këtyre takimeve, përfaqësuesit e niveleve të ndryshme të qeverisjes lokale mund të ndajnë informacion, të shqyrtojnë sfidat dhe të diskutojnë mënyrat për t'i adresuar ato. Ky proces ndihmon në forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit të veprimeve midis të gjitha niveleve të qeverisjes lokale për të përmirësuar shërbimet dhe të përmirësuar jetën e banorëve.

Kryetarët e Këshillave Lokale, ftohen të marrin pjesë në takime konsultative, debate publike dhe konsultime publike me qytetarë⁷.

Ky Nen thekson rëndësinë e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të përfaqësuesve të këshillave lokale në procese konsultative dhe debate publike në nivel komunal. Përmes pjesëmarrjes në takime të tilla, kryetarët e këshillave lokale mund të ndajnë pikëpamjet e tyre, të shprehin interesat e komunitetit dhe të japin kontributin e tyre në formulimin e politikave dhe vendimeve lokale. Ky përforsim ndihmon në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe përfshirjes së qytetarëve në procesin vendimmarrës lokal. Në të njëjtën kohë, kjo sjellje e hapur dhe bashkëpunuese promovon marrëdhëniet e mira dhe besueshmërinë midis qeverisë lokale dhe qytetarëve të saj.

6 Neni 11, Par. 1 i Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR. 02/2019 Për Organizimin, Funkcionimin Dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, i qashëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=21224>

7 Neni 11, Par. 2 i Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR. 02/2019 Për Organizimin, Funkcionimin Dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, i qashëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=21224>



Kuvendi komunal duhet të konsultojë këshillin lokal, në çështje të caktuara me interes për komunitetin

Ky Nen përcakton një mekanizëm të rëndësishëm për të siguruar përfshirjen dhe pjesëmarrjen e këshillave lokale në procesin vendimmarrës të kuvendit komunal në çështje që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në komunitetin lokal. Kjo lloj konsultimi dhe bashkëpunimi ndihmon në sigurimin e një perspektive të gjerë dhe të përfaqësuese për diskutimin dhe vendimmarrjen. Përveç kësaj, ky proces përforcon marrëdhëniet dhe bashkëpunimin midis kuvendit komunal dhe këshillave lokale, duke krijuar një mjedis më të përfshirë dhe më të qëndrueshëm për zhvillimin e komunitetit lokal.

5. ZBATIMI I UDHËZIMIT ADMINISTRATIV

Shfuqizimi i Udhëzimit Administrativ të mëparshëm (Nr. 2008/08) dhe zëvendësimi i tij me Udhëzimin e ri Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 Për Organizimin, Funkcionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane ishte një hap i rëndësishëm drejt rishikimit dhe përmirësimit të praktikave të administratës lokale. Një rishikim i rregullt i udhëzimeve administrative është i domosdoshëm për të reflektuar zhvillimet e reja ligjore, politikat dhe praktikat e mira në fushën e qeverisjes lokale.

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi të ri Administrativ, pritet që komunat të zbatojnë dhe të respektojnë dispozitat dhe kushtet e tij në mënyrë të plotë dhe të përshtatshme, duke krijuar një mjedis të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm për zhvillimin dhe mirëqenien e komunitetit lokal.

Neni 16 i Udhëzimit Administrativ përcakton një detyrim ligjor për të gjitha komunat për të ndryshuar ose plotësuar rregulloret e tyre komunale brenda një afati prej gjashtë muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ. Kjo detyrë përcakton një proces të qartë dhe të përcaktuar për përshtatjen e rregulloreve komunale me dispozitat dhe kërkesat e këtij Udhëzimi, duke rezultuar në zbatueshmërinë me përpikëri të këtij detyrim ligjor. Gjithashtu, përditësimet e tilla sjellin qartësi në procedurat administrative, duke siguruar që të gjithë palët e interesuara janë të informuar për rregullat dhe detyrimet e tyre të reja në kuadër të bashkëpunimit të komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.

Për të përmbushur këtë detyrim, komunat duhet të bëjnë një vlerësim të hollësishëm të rregulloreve të tyre ekzistuese dhe të identifikojnë çdo ndryshim ose plotësim që është i nevojshëm për përputhshmërinë me Udhëzimin Administrativ. Për më tepër, komunat duhet të kryejnë konsultime të përshtatshme me palët e interesuara lokale dhe të sigurojnë transparencë dhe përfshirje në procesin e përditësimit të rregulloreve komunale.

Është e rëndësishme gjithashtu që komunat të përcaktojnë një plan veprimi të qartë dhe të monitorojnë përparimin e tyre në përmbushjen e këtij detyrimi. Kjo përfshin monitorimin e afatit kohor dhe të resurseve të nevojshme për të siguruar zbatimin e plotë dhe të suksesshëm të ndryshimeve në rregulloret komunale.

5.1 Përgjegjësia për zbatimin e Udhëzimit Administrativ

Neni 14 i Udhëzimit Administrativ përcakton qartë kryetarin/en e komunës si personin përgjegjës për zbatimin e të gjitha dispozitave të këtij Udhëzimi. Ky përcaktim i një personi përgjegjës për zbatimin e Udhëzimeve ka për qëllim të sigurojë që procesi i zbatimit të jetë i përshtatshëm dhe i ndjekur me kujdes.

Kryetari i komunës, si përgjegjësi për zbatimin e Udhëzimit Administrativ, duhet të ketë një rol aktiv në monitorimin dhe sigurimin e implementimit të politikave dhe procedurave të përcaktuara në Udhëzim. Kjo përfshin kryesimin e koordinimit të aktiviteteve, monitorimit të progresit të zbatimit dhe adresimit të çdo sfide që mund të dal gjatë procesit. Në këtë kontekst, **është thelbësore që kryetari/ja i komunës të ketë një rol proaktiv në udhëzimin e ekipit të tij drejt zbatimit të politikave dhe procedurave në mënyrë të saktë dhe efikase.** Kryetari/ja i komunës duhet të ketë përgjegjësinë për të siguruar që të gjithë palët përfshirëse në procesin e zbatimit janë të përfshirë dhe të informuar në mënyrë të përshtatshme.

Në fund, një rol i qëndrueshëm dhe efikas i kryetarit/es të komunës në zbatimin e Udhëzimit

Administrativ është i rëndësishëm për të siguruar që qëllimet dhe synimet e Udhëzimit të arrihen në mënyrë të përshtatshme dhe të drejtë.

5.2 Monitorimi i zbatimit të Udhëzimit Administrativ

Neni 15 i Udhëzimit Administrativ rëndon përgjegjësinë e monitorimit të zbatimit të udhëzimeve nga një entitet i pavarur dhe specializuar, në këtë rast Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Ky mekanizëm i monitorimit është jetik për sigurimin e zbatimit të drejtë dhe të përshtatshëm të Udhëzimit Administrativ në të gjithë nivelin e pushtetit lokal.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, si organi përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Udhëzimeve Administrative, duhet të ketë resurset dhe kapacitetet për të ndjekur me kujdes përparimin dhe përputhshmërinë e zbatimit të Udhëzimit në të gjithë nivelin komunal. Kjo përfshin vlerësimin e përgjegjshmërisë së komunave në implementimin e politikave dhe procedurave të përcaktuara në Udhëzim.

Një monitorim i rregullt dhe efikas i zbatimit të Udhëzimeve Administrative siguron që çdo shkelje ose moszbatim i tyre të identifikohet dhe trajtohet me kohë, duke përmirësuar kështu integritetin dhe efikasitetin e procesit vendimmarrës në nivel lokal. Kjo gjithashtu rrit nivelin e transparencës dhe llogaridhënies në mesin e autoriteteve lokale dhe publikut të gjerë.

Për të garantuar një monitorim të suksesshëm të zbatimit të Udhëzimeve Administrative, është e rëndësishme që Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të ketë një rol aktiv në përcaktimin e kriterëve të monitorimit, mbledhjen e të dhënave relevante dhe raportimin e rezultateve të monitorimit në një mënyrë transparente dhe të qartë.

5.3 Financimi i aktiviteteve të Këshillave Lokale

Neni 13 i Udhëzimit Administrativ thekson rëndësinë e disponueshmërisë së burimeve financiare për të mbështetur aktivitetet dhe projektet e këshillave lokale. Financimi i këtyre aktiviteteve mund të vijë nga një gamë e gjerë burimesh, duke përfshirë:

- a) **Kontributet e banorëve** të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane: Kjo është një formë e rëndësishme e financimit lokal që inkurajon pjesëmarrjen aktive të komunitetit në zhvillimin e aktiviteteve të tyre. Kontributet e tyre, në formën e kontributeve financiare ose të punës vullnetare, mund të jenë një burim i rëndësishëm për të financuar projekte dhe aktivitete të rëndësishme për komunitetin.
- b) **Financimi nga komuna përkatëse:** Komuna përkatëse është një burim themelor për financimin e aktiviteteve të këshillave lokale. Përshkrimi i buxhetit të komunës përkatëse dhe alokimi i fondeve për projektet dhe aktivitetet lokale është jetik për të siguruar që nevojat e komunitetit të adresohen në mënyrë efektive dhe të përshtatshme.
- c) **Donatorët:** Kontributet nga donatorët, përfshirë organizatat e qeverisë lokale, organizatat jo-qeveritare, kompanitë private, dhe individët e pasur, mund të jenë një burim shtesë i financimit për projektet dhe aktivitetet lokale. Kjo kërkon një përpjekje të vazhdueshme për të identifikuar dhe siguruar mbështetjen e duhur financiare nga këto burime.
- d) **Financim i përbashkët:** Në rastet kur një projekt ose aktivitet ka përfitime të përbashkëta për disa komunitete ose partnerë lokalë, financimi i përbashkët mund të jetë një zgjidhje e favorshme. Kjo sjellje e burimeve mund të forcojë bashkëpunimin dhe të sigurojë që projekti të ketë ndikim maksimal në zonën e interesit të përbashkët.

Për të siguruar një financim të qëndrueshëm dhe efektiv për aktivitetet lokale, është e rëndësishme që këshillat lokale të krijojnë marrëdhënie të mira me të gjitha burimet e mundshme financiare dhe të hartojnë strategji për përdorimin sa më efikas të tyre.

5.4 Kompensimi financiar i kryetarëve të Këshillave Lokale

Neni 12 i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 Për Organizimin, Funkzionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane përcakton mënyrën se si do të kompensohen kryetarët e këshillave lokale për punën e tyre. Është e rëndësishme që kjo të bëhet në mënyrë transparente dhe në përputhje me rregullat e përcaktuara.

Së pari, marrëveshja që kryetarët e këshillave lokale do të kompensohen nga buxheti i komunës për punën e tyre **thekson përgjegjësinë financiare të komunës ndaj këtyre përfaqësuesëve**. Kjo mundëson që ata të jenë në gjendje të mbulojnë të paktën disa shpenzime administrative drejt realizimi të detyrave të tyre ndaj qytetarëve që përfaqësojnë.

Është e rëndësishme të përmendet që kompensimi për kryetarët e këshillave lokale **bëhet në shumën ekuivalente të anëtarëve të komiteteve obligative**. Ky vendim është i arsyeshëm, pasi nuk bënë ndarje të rëndësishme në mes të punës së komiteteve obligative dhe këshillave lokale.

Kompensimi për pjesëmarrjen në takime bëhet vetëm për gjashtë takime të këshillit lokal të mbajtura brenda vitit kalendarik. Kjo është një masë e rëndësishme për të siguruar që pagesa e kryetarëve të këshillave lokal është e bazuar në prezencën e tyre aktive dhe kontributin e vërtetë në proceset vendimmarrëse lokal. Kjo gjithashtu inkurajon përkushtimin dhe pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet e këshillit.

Sidoqoftë, kompenzimi mund të bëhet pasi disa procedura dhe rregulla ndiqen nda të dy palët - komuna dhe kryetarët e këshillave lokale.

5.4.1 Udhëzime për Komunitat

Bazuar në një analizën ligjore të përgatitur nga Platforma CiviKos⁸, lidhur me kompensimin e kryetarëve të këshillave lokale, është konstatuar se ekzistojnë dilema rreth pagesës së kryetarëve të këshillave lokale. Kjo ka shkaktuar sfida në funksionimin e këshillave lokale, dhe ka pamundësuar realizimin e qëllimeve për të cilat ato ekzistojnë. Sidoqoftë, **nga kjo analizë është konstatuar se nuk ekzistojnë pengesa ligjore që komunitat të kompenzojnë kryetarët e këshillave lokale, nëse ndjekin një rrugë të qartë ligjore**. Në këtë drejtim, në vijim janë listuar **hapat që komunitat duhet të ndjekin për të zbatuar pagesën në mënyrë të unifikuar dhe efektive**:

- 1) Përditësimi i Rregulloreve Komunale për bashkëpunim me Bashkësitë Lokale** - Çdo komunë e cila nuk ka përditësuar rregulloren, duhet të përditësojë rregulloren përkatëse komunale për **bashkëpunim me fshatrat dhe, vendbanimet dhe lagjet urbane**, me të cilën specifikon zgjedhjen e kryetarëve të bashkësive lokale, mënyrën e funksionimit të bashkësive lokale, përfshirë organizimin e takimeve dhe kompensimin e kryetarëve. Ky përditësim duhet të jetë në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funkzionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane.
- 2) Zgjedhja e kryetarëve të këshillave lokale** - Komunitat duhet të mbikëqyrin procesin e zgjedhjes dhe funksionimit të këshillave lokale, duke siguruar që kryetarët e këshillave lokale të jenë legjitim dhe të zgjedhur në mënyrë transparente dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. **Pas zgjedhjeve, në vendimin për zgjedhjen e kryetarëve të këshillave lokale të cilin e miraton kuvendi komunal, do duhej të ceket edhe shuma e kompenzimit për**

⁸ Analizë e Bazës Ligjore për Kompensimin e Kryetarëve të Këshillave Lokale (Platforma CiviKos, 2024), e qasshme në: <https://civikos.net/wp-content/uploads/2024/11/Analiza-shqip.pdf>

mbledhjes, mbajtja e procesverbaleve, evidencave të rregullta të takimeve për të justifikuar kompensimin, si dhe kategoria e shpenzimeve nga e cila do të kompensohen kryetarët e këtyre këshillave.

- 3) Buxhetimi i Kompensimit** - Komunitat duhet të planifikojnë një buxhet për kompensimin e kryetarëve të këshillave lokale. Ky kompensim bazohet në pjesëmarrjen në takime (maksimumi 6 takime në vit) dhe sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2019 është ekuivalent me kompensimin e anëtarëve të komiteteve obligative. Rrjedhimisht, **komunitat duhet të analizojnë të dhënat për numrin e kryetarëve dhe të buxhetojnë masë monetare përkatëse. Ky buxhetim do të mund të bëhet në kuadër të kuvendit komunal.**
- 4) Propozime për kategorinë e shpenzimeve** - **Duke qenë se kryetarët e këshillave lokale nuk janë të punësuar të komunës, kompensimi i tyre do të mund të bëhet nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.** Kryetarët e këshillave duhet të kompensohen për shërbimet që ofrojnë në mbledhjet e këshillave lokale. Komunitat duhet të caktojë sasinë e kompensimit dhe numrin e takimeve që do të kompensohen brenda vitit si dhe kategorinë ekonomike nga do të realizohet pagesa, duke e bazuar këtë në evidencën e takimeve të mbajtura. Kjo duhet të përcaktohet edhe në vendimin përkatës për zgjedhjen e tyre.

Në rast të paqartësive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) mund të ofrojnë këshilla ligjore për zbatimin praktik të kompensimit të kryetarëve të këshillave lokale. Duke ndjekur këto hapa, komunitat do të mundësojnë funksionimin efektiv të këshillave lokale dhe do të rrisin pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

5.4.2 Udhëzime për Këshillat Lokale

Për të siguruar operimin efektiv të Këshillave Lokale, për të përmbushur kërkesat e Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2019, si dhe për të pranuar kompensimin financiar, këshillat lokale dhe kryetarët e tyre duhet të ndjekin këto udhëzime:

1) Organizimi dhe Mbajtja e Takimeve

- Planifikimi dhe Ftesat: Kryetarët e Këshillave duhet të organizojnë së paku gjashtë (6) takime gjatë vitit kalendarik, siç parashikohet në Nenin 12 të Udhëzimit Administrativ. Ftesat për takime duhet të përfshijnë agjendën dhe të shpërndahen së paku shtatë (7) ditë më parë.
- Përgatitja e Procesverbaleve: Çdo takim duhet të dokumentohet me një procesverbal zyrtar, ku përfshihet data, vendi, kuorumi, dhe vendimet e marra.
- Lisa e pjesëmarrësve: secili pjesëmarrës në takim duhet të regjistrohet, të ketë një numër kontakti apo adresë elektronike, dhe të nënshkruhen. Pjesëmarrja mund të dokumentohet shtesë edhe me fotografi apo video, nëse është marrë pëlqimi i pjesëmarrësve për t'i fotografuar.

2) Ruajtja dhe Dokumentimi i Vendimeve

- Regjistri i Vendimeve: Të gjitha vendimet e marra nga Këshillat Lokale duhet të regjistrohen sipas Nenit 6 të Udhëzimit Administrativ. Ky regjistër duhet të përmbajë informacione të sakta dhe të jetë i qasshëm për inspektim nga autoritetet komunale.
- Raporte Periodike: Raporte mbi aktivitetet dhe realizimet e këshillit duhet të dorëzohen në komunë për çdo gjashtë (6) muaj.

3) Deklarimi i Etikës dhe Konfliktëve të Interesit

- Përputhja me Standardet Etike: Kryetarët dhe anëtarët e këshillave duhet të nënshkruajnë deklaratatë të përputhjes me standardet etike, duke shmangur konfliktet e interesit gjatë ushtrimit të detyrave.

4) Kërkesa për Kompensim

- Kriteret për Kompensim: Kryetarët duhet të dokumentojnë pjesëmarrjen në takime dhe të sigurojnë procesverbalet dhe listën e pjesëmarrësve për të justifikuar kompensimin e tyre, siç përcaktohet në Nenin 12.
- Afatet për Parashtrim të Dokumenteve: Dokumentacioni për justifikimin e kompensimit duhet të dorëzohet në komunë në përputhje me udhëzimet komunale.


5) Bashkëpunimi me Komunën

- Kryetarët duhet të marrin pjesë në konsultimet periodike të organizuara nga kryetari/ja i/e komunës dhe kryesuesi/ja i/e kuvendit të komunës, siç kërkohet nga Neni 11 i Udhëzimit.

6) Monitorimi dhe Llogaridhënia

- Kryetarët janë përgjegjës për raportimin e progresit dhe përmbushjen e detyrave të këshillit tek komuna. Raportimi duhet të jetë transparent dhe i bazuar në të dhëna të sakta

Këto udhëzime janë thelbësore për të siguruar funksionimin e rregullt dhe përmbushjen e përgjegjësive ligjore të këshillave lokale. Respektimi i tyre ndihmon në krijimin e një partneriteti të fortë midis këshillave dhe komunave dhe në adresimin efektiv të nevojave të komunitetit. Shembujt e dokumenteve për të lehtësuar ndjekjen e këtyre udhëzimeve janë të dhëna në kapitullin vijues.



6. SHEMBUJ TË DOKUMENTEVE PËR KËSHILLAT LOKALE

Ftesa

Shënim: Pjesët e hijëzuara plotësohen me informacionet përkatëse, pasi këtu janë dhënë vetëm si shembuj. Preferohet që ftesa të dërgohet së paku një javë përpara.

Këshilli Lokal XY

Në pajtim me Ligjin (nr. 03/l-040) Për Vetëqeverisje Lokale, Neni 34, dhe Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 02/2019 Për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, Neni 1, si dhe Rregulloren për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Komunën XY, ftoheni në takimin e mëposhtëm.

Ftesë për Takim

Koha: 5 Shtator 2024, ora 18:00

Vendi: Salla e Takimeve të Komunës, XY

Të Nderuar Anëtarë të Këshillit Lokal / qytetarë (varësisht nëse takimi mbahet me anëtarët e Këshillit apo me qytetarët e tjerë),

Ju ftojme të merrni pjesë në takimin e rradhës së Këshillit Lokal XY, i cili do të mbahet më datë **5 Shtator 2024** në **Sallën e Takimeve të Komunës, XY**.

Qëllimi i Takimit:

Diskutimi dhe vendimmarrja për çështje të rëndësishme që lidhen me nevojat dhe prioritetet e komunitetit tonë, përfshirë organizimin e një takimi të hapur me qytetarët dhe planifikimin e aktiviteteve për muajin e ardhshëm.

Agjenda:

- Hapja e Takimit dhe Miratimi i Rendit të Ditës**
- Raportimi mbi Aktivitetet e Kryera nga Këshilli Lokal**
(Iniciativat për përmirësimin e infrastrukturës lokale dhe fushatën për mbrojtjen e ambientit)
- Diskutimi dhe Vendimet për Planin e Punës për Muajin e Ardhshëm**
(Organizimi i një takimi të hapur me qytetarët dhe identifikimi i nevojave të tyre)
- Çështje të Ndryshme**
(Diskutimi për përmirësimin e sigurisë në lagje dhe përmirësimin e shërbimeve komunale)
- Mbyllja e Takimit**

Ju lutemi konfirmoni pjesëmarrjen tuaj dhe përgatitni ndonjë çështje/propozim që dëshironi të shtoni në rendin e ditës.

Me respekt,

Emri dhe Mbiemri

Kryetari i Këshillit Lokal XY

Procesverbali

Shënim: Pjesët e hijëzuara plotësohen me informacionet përkatëse, pasi këtu janë dhënë vetëm si shembuj. Në këtë rast, edhe teksti tjetër përbërës i dokumentit është i dhënë vetëm si shembull dhe formë, dhe duhet t'i përshtatet aktiviteteve të Këshillit përkatës. Procesverbalit duhet t'i bashkëngjitet lista e pjesëmarrësve të nënshkruar. Preferohet të bëhen edhe foto/video të takimit për dokumentim shtesë, pasi të merret pëlqimi i pjesëmarrësve për t'u fotografuar.

Procesverbal i Takimit të Këshillit Lokal XY

Koha: 25 Gusht 2024, ora 18:00

Vendi: Salla e Takimeve të Komunës XY

Numri i Pjesëmarrësve: 10 (Lista e pjesëmarrësve e nënshkruar është bashkëngjitur në këtë dokument)

Të Dhënat e Pjesëmarrësve:

- **Kryetari i Këshillit Lokal:** Emri dhe Mbiemri XY
- **Anëtarët e Këshillit Lokal të pranishëm në takim:**

1. Emri dhe Mbiemri XY	4. Emri dhe Mbiemri XY
2. Emri dhe Mbiemri XY	5. Emri dhe Mbiemri XY
3. Emri dhe Mbiemri XY	6. Emri dhe Mbiemri XY

Pikat e Rendit të Ditës:

- Hapja e Takimit dhe Konstatimi i Kuorumit**
 - Takimi u hap nga Kryetari, Emri dhe Mbiemri XY, i cili konstatoi se kuorumi është plotësuar për të mbajtur mbledhjen e rregullt. Më pas, ai prezantoi rendin e ditës, i cili u miratua.
 - Shëno numrin e personave që janë pajtuar dhe nëse ka që nuk janë pajtuar.
- Raportimi mbi Aktivitete të Kryera nga Këshilli Lokal** (shëno periudhën raportuese, shembull: Gjatë muajit Gusht)
 - Kryetari prezantoi raportin e aktiviteteve të kryera gjatë muajit të fundit, duke përfshirë iniciativat për përmirësimin e infrastrukturës lokale dhe organizimin e një fushatë ndërgjegjësimit për mbrojtjen e ambientit. Të gjitha aktivitetet u diskutuan dhe u miratuan nga anëtarët e Këshillit.
 - Shëno nëse ka pasur vërejtje dhe rekomandime shtesë për periudhën raportuese.
- Diskutimi dhe Vendimet për Planin e Punës për Muajin e Ardhshëm**
 - U diskutua dhe u vendos për organizimin e një takimi të hapur me qytetarët për të identifikuar nevojat dhe prioritetet e tyre për investime të ardhshme në komunitet. U caktua data 5 Shtator 2024 për këtë takim.
 - Shëno të gjitha vendimet për aktivitetet e ardhshme.
- Të Ndryshme**
 - Anëtarët diskutuan XY çështjet që prekin komunitetin, përfshirë rritjen e sigurisë në lagje dhe përmirësimin e shërbimeve komunale.
 - Shëno gjithçka tjetër që u diskutua dhe vendos gjatë takimit.

Mbyllja e Takimit

Takimi u mbyll nga Kryetari në ora 19:30, me një falënderim të veçantë për pjesëmarrjen aktive të gjithë anëtarëve.

Nënshkrimet:

- **Kryetari i Këshillit Lokal:** _____
- **Procesmbajtësi:** _____
- **Anëtarët e Këshillit Lokal:**

1. Emri dhe Mbiemri XY	_____
2. Emri dhe Mbiemri XY	_____
3. Emri dhe Mbiemri XY	_____
4. Emri dhe Mbiemri XY	_____

Data: 25 Gusht 2024

Vendi: XY

Lista e nënshkruar e pjesëmarrësve është e bashkëngjitur si aneks i këtij procesverbali.

Lista e pjesëmarrësve

Shënim: Pjesët e hijëzuara plotësohen me informacionet përkatëse, pasi këtu janë dhënë vetëm si shembuj. Lista e pjesëmarrësve të nënshkruar i bashkangjitet proseverbalit dhe dokumenton se takimi është mbajtur. Për secilin pjesëmarrës duhet të ketë edhe një numër kontakti apo adresë elektronike për t'i identifikuar dhe verifikuar në rast se nevojitet.

Preferohet të bëhen edhe foto/video të takimit për dokumentim, por pasi të merret pëlqimi i pjesëmarrësve për t'u fotografuar. Në rast se ka pjesëmarrës që nuk duan të fotografohen, vendimi i tyre duhet të respektohet pasi kjo e drejtë garantohej me ligj.

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, numri i telefonit është e dhënë personale ndaj dhe kjo listë duhet të mbahet me kujdes dhe të dhënat të mos shpërndahen.

Takimi i Këshillit Lokal XY

Lista e pjesëmarrësve

Vendi: _____ Data: _____

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nr. i kontaktit	A pranoi të fotografoheni? PO/JO	Nënshkrimi
1				
2				
3				
4				
5				
6				
7				
8				

*Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në aktivitetet dhe jo për qëllime të tjera.

Regjistri i vendimeve

Shënim: Pjesët e hijëzuara plotësohen me informacionet përkatëse, pasi këtu janë dhënë vetëm si shembuj. Në këtë rast, edhe teksti tjetër përbërës i dokumentit është i dhënë vetëm si shembull dhe formë, dhe duhet t'i përshtatet vendimeve të Këshillit përkatës. Regjistri i vendimeve duhet të përditësohet pas çdo takimi të këshillit për të reflektuar të gjitha vendimet e marra. Rezultatet e votimit duhet të përfshijnë numrin e votave për, kundër dhe abstenim kur është e nevojshme. Shënimet shtesë mund të përfshijnë informacione të rëndësishme për zbatimin e vendimeve ose vërejtje të bëra gjatë takimit.

Regjistri i Vendimeve të Këshillit Lokal XY

Nr.	Data	Tema	Përshkrimi i Vendimit	Rezultati i Votimit	Shënime Shtesë
1	25 Gusht 2024	Miratimi i Rendit të Ditës	Miratimi i rendit të ditës për takimin e datës 25 Gusht 2024.	Miratuar njëzëri	
2	25 Gusht 2024	Raportimi mbi Aktivitetet e Kryera	Miratimi i raportit mbi aktivitetet e kryera gjatë muajit të fundit.	Miratuar njëzëri	
3	25 Gusht 2024	Planifikimi i Takimit të Hapur me Qytetarët	Vendosja e datës dhe tematikave për takimin e hapur me qytetarët më 5 Shtator 2024.	Miratuar me shumicë votash	
4	25 Gusht 2024	Zgjedhja e Anëtarit të Ri të Këshillit	Zgjedhja e Emri dhe Mbiemri XY si anëtar i ri i Këshillit Lokal.	Emri dhe Mbiemri XY: 8 vota, Emri dhe Mbiemri XY: 2 vota	
5	25 Gusht 2024	Përmirësimi i Sigurisë në Lagje	Vendimi për organizimin e një fushate për rritjen e sigurisë në lagje.	Miratuar me shumicë votash	

Data e përgatitjes: 25 Gusht 2024

Përgatitur nga: Emri dhe Mbiemri XY, Kryetari i Këshillit Lokal

Deklarimi i etikës dhe konflikteve të interesit

Shënim: Pjesët e hijëzuara plotësohen me informacionet përkatëse, pasi këtu janë dhënë vetëm si shembuj.

Në Pajtim me Ligjin (nr. 03/l-040) Për Vetëqeverisje Lokale, Neni 34, Ligjin (nr. 06/l -011) Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Neni 17, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 02/2019 për Organizimin, Funkcionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, Neni 1, dhe Rregulloren për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Komunën XY, nënshkruaj këtë:

Deklarata e Etikës dhe Konfliktit të Interesit

Këshilli Lokal XY

Data: Data e Nënshkrimit

Deklaratë e Përgjithshme

Unë, i nënshkruari, **EMRI DHE MBIEMRI XY**, si **anëtar/kryetar i Këshillit Lokal të XY**, duke pranuar përgjegjësitë dhe obligimet që më janë dhënë, deklaroj se do të veproj me integritet të plotë, ndershmëri dhe përkushtim ndaj interesave të komunitetit që përfaqësoj. Unë angazhohem që gjatë ushtrimit të detyrave të mia do të ndjek parimet e etikës dhe do të shmang çdo situatë që mund të krijojë një konflikt interesi.

Parimet e Etikës

- Integriteti:** Angazhohem të veproj në përputhje me parimet më të larta të integritetit dhe ndershmërisë në të gjitha veprimet dhe vendimet që marr si **anëtar/kryetar i Këshillit Lokal**.
- Transparenca:** Do të siguroj që veprimet e mia të jenë të hapura dhe të qarta, duke lejuar që të gjithë qytetarët të kenë qasje në informacionin përkatës.
- Përgjegjësia:** Do të mbaj përgjegjësi të plotë për vendimet dhe veprimet e mia, duke qenë i gatshëm të jap llogari për to para komunitetit dhe kolegëve të mi.
- Respekti për Ligjin:** Do të respektoj të gjitha ligjet dhe rregulloret që lidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Lokal.

Konflikti i Interesit

- Deklarimi i Interesave:** Nëse gjatë ushtrimit të detyrave të mia përballem me një situatë ku interesat personale, financiare, ose familjare mund të ndikojnë në vendimet e mia, angazhohem të deklaroj menjëherë këtë konflikt dhe të heq dorë nga vendimmarrja në atë çështje.
- Shmangia e Përfitimeve Personale:** Nuk do të përdor pozicionin tim në Këshillin Lokal për të përfituar personalisht, direkt ose indirekt, në dëm të interesave të komunitetit.
- Njoftimi i Konflikteve Potenciale:** Do të njoftoj Këshillin për çdo situatë që mund të krijojë një konflikt interesi, edhe nëse ajo nuk është aktualisht e qartë, për të siguruar që veprimet e mia janë në përputhje me standardet më të larta etike.

Pranimi dhe Nënshkrimi

Duke nënshkruar këtë deklaratë, unë pranoj se e kam lexuar, kuptuar dhe pranoj të respektoj këto parime gjatë gjithë periudhës së shërbimit tim në Këshillin Lokal.

Emri dhe Mbiemri: _____

Nënshkrimi: _____

Data: _____

Raportet

Shënim: Pjesët e hijëzuara plotësohen me informacionet përkatëse, pasi këtu janë dhënë vetëm si shembuj. Në këtë rast, edhe teksti tjetër përbërës i dokumentit është i dhënë vetëm si shembull dhe formë, dhe duhet t'i përshtatet aktiviteteteve të Këshillit përkatës.

Në pajtim me Ligjin (nr. 03/l-040) Për Vetëqeverisje Lokale, Neni 34, dhe Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 02/2019 Për Organizimin, Funksonimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, Neni 1, 14 dhe 15, si dhe Rregulloren për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Komunën XY, paraqesim raportin në vijim.

Raport i Aktivitetit të Këshillit Lokal XY

Periudha: Maj-Gusht 2024

Data e Raportit: 1 Shtator 2024

Vendi: XY

1. Hyrje

Ky raport përmbledh aktivitetet e realizuara nga Këshilli Lokal XY gjatë periudhës Maj-Gusht 2024, duke përfshirë progresin e arritur, sfidat e hasura, dhe rekomandimet për të ardhmen.

2. Aktivitetet e Realizuara

Gjatë periudhës Maj-Gusht 2024, Këshilli Lokal XY ka realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- **Përmirësimi i Infrastrukturës lokale dhe monitorimi nga ana e Këshillit:**
 - Komuna XY ka realizuar riparimin e rrugës kryesore në fshatin XY dhe përmirësimi i ndriçimit publik në disa zona.
 - Këshilli Lokal në bashkëpunim me Komunën ka bërë mbikëqyrjen e punimeve dhe ka adresuar çështjet si më poshtë:
 - XY.
 - XY.
 - XY.
- **Fushata për Mbrojtjen e Ambientit:**
 - Organizimi i një fushate ndërgjegjësimi për riciklimin e mbeturinave, në të cilën morën pjesë banorët e fshatit.
 - Vendosja e koshave të rinj për mbeturina në zona të ndryshme të fshatit.
- **Takimet me Komunitetin:**
 - Janë mbajtur X takime me qytetarët për të diskutuar nevojat dhe shqetësimet e tyre. Gjatë takimeve u identifikuan këto sfida dhe dolën këto rekomandime

3. Progresi i Arritur

- **Infrastruktura:** Është bërë përmirësim i dukshëm në gjendjen e rrugës kryesore dhe ndriçimit publik, duke rritur sigurinë dhe komoditetin për banorët.
- **Mbrojtja e Ambientit:** Fushata e riciklimit ka rezultuar në një rritje të ndërgjegjësimit për mbrojtjen e ambientit dhe ka ndihmuar në uljen e ndotjes në fshat.
- **Angazhimi i Komunitetit:** Takimi me qytetarët ka përmirësuar komunikimin dhe bashkëpunimin në mes të Këshillit dhe banorëve, duke kontribuar në vendimmarrje më të informuar.

4. Sfidat e Hasura

- **Mungesa e Financimit:** Ka pasur vështirësi në sigurimin e fondeve të mjaftueshme për të përfunduar të gjitha aktivitetet e planifikuara.
- **Pjesëmarrja e Ulet në Disa Aktivitete:** Disa aktivitete, si fushata e riciklimit, kanë pasur

pjesëmarrje të ulët nga ana e qytetarëve, gjë që ka kufizuar ndikimin e tyre.

5. Rekomandime për të Ardhmen

- **Sigurimi i Burimeve të Reja Financiare:** Këshilli duhet të eksplorojë mundësi të reja për financim, përfshirë aplikimin për grante dhe bashkëpunimin me organizata të tjera.
- **Rritja e Ndërgjegjësimit të Komunitetit:** Është e nevojshme të organizohen aktivitete të tjera për të rritur ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në iniciativat lokale.
- **Përmirësimi i Koordinimit me Komunën:** Vazhdimi i bashkëpunimit të ngushtë me Komunën për të siguruar mbështetje më të madhe në zbatimin e aktiviteteve ndërgjegjesuese.

6. Përfundim

Ky raport ofron një vlerësim të përgjithshëm të aktiviteteve të Këshillit Lokal gjatë periudhës **Maj-Gusht 2024**. Përkundër sfidave të hasura, është bërë progres i dukshëm në disa fusha kyçe, dhe rekomandimet për të ardhmen do të ndihmojnë në përmirësimin e mëtejshëm të punës së Këshillit.

Nënshkrimi

Emri dhe Mbiemri **XY**

Kryetari i Këshillit Lokal XY

Data: **1 Shtator 2024**

Vendi: **XY**

